



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova**  
**Republic of Kosovo**



**Komuna e Kaçanikut**  
**Opština Kacanik**  
**Municipal Kacanik**

01Nr.104/02-12282

Data: 22.08.2025

## **1. Hyrje**

Përmes këtij Raporti përmbledhës të Konsultimeve Publike synohet që të dokumentohen të gjitha format e konsultimit publik që I kanë paraprirë përpilimit/ draftimit të projekt-propozimit të buxhetit nga ana e ekzekutivit të komunës. Kjo nënkupton që përfshihen takimet publike obligative të mbajtura në gjashtëmujorin e parë nga ana e Kryetarit, format të konsultimit publik në të shkruar, dëgjimet buxhetore për KAB e po ashtu ato për buxhet vjetor, etj.

Në bazë të Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në Komuna 04/2023, përcaktohen rregullat që sigurojnë përfshirjen e qytetarëve dhe grupeve përfaqësuese në vendimmarrje lokale, transparencën dhe llogaridhënien e organeve të komunës, gjithashtu përcakton rregullat, parimet, format, procedurat dhe standardet minimale të konsultimit publik në komuna me rastin e zhvillimit të politikave dhe akteve nënligjore në komunë si dhe obligimet e komunave për të siguruar qasjen nëpërmjet teleprezencës dhe teknologjisë digjitale për të garantuar transmetimin në distancë dhe monitorimin nga autoritetet qendrore, shoqëria civile dhe qytetarët. Sipas këtij Udhëzimi, Komuna duhet të siguroj përfshirjen e qytetarëve në konsultime dhe vendimmarrje duke përdorur por duke mos u kufizuar në mbajtjen e:

- 1.1 Takimeve publike;
- 1.2 Konsultim publik për projekt aktet normative dhe dokumente të politikave;
- 1.3 Takime konsultative me qytetarë;
- 1.4 Dëgjime buxhetore.

Me qëllim të dokumentimit të mbajtjes së takimeve, konsultimeve publike, dëgjimeve buxhetore dhe takimeve tjera, komuna siguron ftesat, materialet, sigurimin e kushteve, mbajtjen e procesverbalit dhe hartimin e raportit nga takimet dhe aktivitetet e përfshirjes së qytetarëve në diskutime dhe konsultime publike, gjatë hartimit të akteve dhe dokumenteve lokale. Zyrtari përgjegjës për hartim të projekt- propozimit gjatë mbajtjes së konsultimit publik mbledh komentet dhe përgatit raport për rezultatet e konsultimit publik.

Sipas nenit 60 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjesive (LMFPP), me saktësi të pjese që ka të bëjë me përgatitjen dhe rishqyrtimin e propozim-buxheteve dhe kërkesave për ndarje buxhetore nga ZKF dhe Kryetari i Komunës, përcaktohet se ZKF i komunës duhet, me ose para 1 Korrikut të vitit aktual kalendarik, t'i dërgojë kryesuesit të secilit departament komunal të komunës një qarkore buxhetore komunale e cila përmban informata dhe udhëzime mbi



- (i) tavanet e shpenzimeve të aplikueshme për departamentin përkatës për vitin e ardhshëm fiskal si dhe vlerësime mbi këto tavane për dy (2) vitet e ardhshme fiskale, dhe
- (ii) metodologjinë dhe formularët që duhet të shfrytëzohen nga departamenti përkatës gjatë përgatitjes së propozim-buxhetit dhe kërkesës për ndarje buxhetore për vitin e ardhshëm fiskal.

Qarkorja buxhetore duhet të përfshijë:

- a) procedurat që duhet përdorur nga departamenti gjatë përgatitjes së propozim buxhetit dhe kërkesës për ndarje buxhetore;
- b) të dhënat të cilat duhet të parashtrohen në propozim-buxhet dhe në kërkesën për ndarje buxhetore;
- c) detale mbi formatin në të cilin duhet të përgatitet propozim-buxheti dhe kërkesa për ndarje buxhetore; dhe
- d) afatin e fundit deri në të cilin departamenti duhet të përfundojë dhe t'i dorëzojë ZKF-së propozimbuxhetin dhe kërkesën për ndarje buxhetore.

#### Ecuria e procesit të konsultimeve publike për projekt buxhetin e vitit 2026

Komuna e Kaçanikut ka themeluar grupin punues për realizimin e procesit të dëgjimeve buxhetore për buxhetin komunal 2026. Grupi punues për hartimin e planit të veprimit për procesin transparent të buxhetit të Komunes së Kaçanikut është themeluar me vendim të Kryetarit të Komunes z. Besim Ilazi, me datë 10.03.2025. Grupi ka pasur në përberje përfaqësues të drejtorive të ndryshme komunale, sidomos ato që kanë rol kyç në procesin e planifikimit të buxhetit e po ashtu përfaqësues të zyrave e njësive të ndryshme në kuadër të komunes që po ashtu janë relevante për këtë proces.

Grupi punues i mbështetur nga projekti DEMOS ka realizuar një punëtori dy ditore për hartimin e planit të dëgjimeve buxhetore e po ashtu për menyrën e planifikimit, organizimit, lehtësimit dhe veprimeve percjellese të dëgjimeve buxhetore dhe gjithë procesit të planifikimit të buxhetit.

Plani i dëgjimeve buxhetore është hartuar dhe gjithashtu është publikuar në ueb faqen dhe rrjetet sociale të Komunës. Plani ka paraparë gjithsej dy konsultime publike për KABK.

Hartimi i këtij dokumenti ka ardhur edhe pas mbajtjes së konsultimit publik me qytetarët për Kornizën Afatmesme Buxhetore.

Publikimet për këto dëgjime buxhetore janë bërë këtu:

Uebfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/kacanik/category/konkurset-njoftimet/konsultime-publike-konkurset-njoftimet/>

Facebook:

<https://www.facebook.com/KomunaKacanik>



## 2. PËRMBLEDHJE TABELARE E KONSULTIMEVE TË MBAJTURA

Të gjitha kërkesat e parashtruara në takimet fizike si dhe ato në formë elektronike, janë shqyrtuar nga Grupi Punues, ndërsa raporti i detajuar për kërkesat e pranuar apo refuzuara, është paraqitur në formë të plotë në shtojcën **nr. 1 të këtij raporti**.

| Metodat e konsultimit/Grupi i interesit                                                  | Data/           | Numri i pjesëmarrësve/Gjinia | Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime | Shpjegimi se a po aprovohet kërkesa (nëse nuk aprovohet me dhënë shpjegimin pse jo)         |
|------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------|------------------------------|----------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------|
| Konsultimi buxhetor per KABK me qytetarët e Komunës së Kaçanikut                         | 13 qershor 2025 | 30 (15 gra, 15 burra)        | 5 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa                   |                                                                                             |
| Konsultimi buxhetor per KABK me sektorin e arsimit                                       | 16 qershor 2025 | 14 (5 gra, 9 burra)          | 6 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa                   | Shumica e kërkesave janë pranuar dhe janë inkorporuar në projektbuxhetin e vitit 2026-2028. |
| Konsultimi buxhetor per Projekt Buxhetin 2026-2028 me sektorin e OJQ dhe Klubet Sportive | 21 korrik 2025  | 18 (13 gra, 5 burra)         | 4 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa                   | Shumica e kërkesave janë pranuar dhe inkorporuar në projektbuxhet 2026-2028.                |
| Konsultimi buxhetor per Projekt Buxhetin 2026-2028 me të rinjët e Komunës së Kaçanikut   | 23 korrik 2025  | 16 (4 gra, 12 burra)         | 4 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa                   | Shumica e kërkesave janë pranuar dhe janë inkorporuar në projektbuxhetin e vitit 2026-2028. |

|                                                                           |                                     |                      |                                                 |                                                                                                                   |
|---------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------|----------------------|-------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Konsultimi<br>buxhetor per<br>Projekt Buxhetin<br>2026-2028 me<br>biznese | 22 korrik<br>2025                   | 17 (14 gra, 3 burra) | 4 pjesëmarrës<br>kanë<br>parashtruar<br>kërkesa | Shumica e<br>kërkesave janë<br>pranuar dhe<br>janë<br>inkorporuar në<br>projektbuxhetin<br>e vitit 2026-<br>2028. |
| Konsultimi<br>buxhetor per<br>Projekt Buxhetin<br>2026-2028 me fermer     | 23 korrik<br>2025                   | 19 (4 gra, 15 burra) | 6 pjesëmarrës<br>kanë<br>parashtruar<br>kërkesa | Shumica e<br>kërkesave janë<br>pranuar dhe<br>janë<br>inkorporuar në<br>projektbuxhetin<br>e vitit 2026-<br>2028. |
| Konsultimi në<br>mënyrë elektronike                                       | 30.05.2025<br>deri më<br>16.06.2025 | 1                    | 1 person 11<br>kërkesa                          |                                                                                                                   |

**KABK 2026-2028, pas përmbylljes së procesit të dëgjimeve buxhetore, është finalizuar dhe proceduar për në Kuvendin e Komunës së Kaçanikut.**

### **3. METODOLOGJIA DHE KRITERET PËR KLASIFIKIMIN E STATUSIT TË KËRKESAVE**

Sipas Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në Komuna 04/2023, të gjitha propozimet, vërejtjet dhe sugjerimet që janë paraqitur nga publiku brenda mënyrës dhe afatit kohor të përcaktuar me dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ, përfshihen në raportin mbi shqyrtimin publik.

Shqyrtimi i komenteve bëhet nga grupi punues i projekt propozimit i cili vendos për pranimin ose refuzimin e rekomandimeve të marra nga palët e interesuara. Në këtë kapitull janë të paraqitura aspektet/kriteret si dhe terminologjia që grupi punues ka marrë për bazë për klasifikimin e statusit të kërkesave. Më poshtë janë të elaboruara detajisht këto aspekte dhe kriteret.

**Pranim/Aprovim:** nënkupton që kërkesa konkrete e qytetarit konsiderohet se është e nevojshme për tu realizuar dhe si e tillë do të jetë pjesë e buxhetit për vitin 2026. Pra kërkesat e tilla, si për projekte kapitale, subvencione apo mallra & shërbime janë në buxhetin që i shkon kuvendit/asamblesë për miratim deri me 1 shtator.



**Adresim:** nënkupton që kërkesa e qytetarit adresohet te subjekti, palët, institucioni relevant. Kjo vlen dhe është relevante në rastet kur kërkesat apo propozimet e qytetarëve nuk janë në kompetencën komunale dhe janë përgjegjësi/kompetencë e një insititucioni tjetër (si psh KEK-ut, Ujësjellësit, etj) dhe kur klasifikohet si e “Adresuar” nënkupton që Komuna do të adresoj apo ka adresuar kërkesën tek institucioni relevant. Adresuar po ashtu mund të nënkuptojë që një kërkesë e qytetarit vetëm se gjenë adresim në projektet ekzistuese komunale (të cilat mund të kenë filluar në vitet paraprake apo janë të planfikuar për vitet pasuese për të cilin po mbahet konsultimi) – që nënkupton se nëse grupi punues nuk është i qartë nëse kjo kërkesë do të jetë me saktësi shembull pjesë e projekteve të vitit 2026, do ta adresoj atë për shqyrtim/përfshirje në buxhet për vitet e ardhshme (term tjetër në këto raste përdoret “E konsideruar” apo “E marrë në konsideratë”).

**Pjesërisht e pranuar/aprovuar:** Nënkupton klasifikimin e kërkesave apo propozimeve të qytetarëve të cilat mund të përfshijnë disa lloj intervenimesh (psh. Në shtrimin e një rruge mund të kërkohej që përveç asflatimit të rrugës, të punohet edhe në ndriqimin publik të asaj rruge apo edhe mbjelljen e drunjëve dekorativ/gjelbrimin përreth saj). Në këto raste, nëse komuna mund të ketë mundësi buxhetore apo thjesht të prioritzoj vetëm një segment të kesaj kërkesë (shembull shtrimin e rrugës) atëherë arsyetohet që për këto arsye, kërkesa aprovohet për shtrimin e rruges, mirepo për vitin 2026 nuk do të ketë mundësi intervenimi në ndriqim publik apo mbjelljen e drunjëve dekorativ. Si e tillë kërkesa mbetet pjesërisht e pranuar/aprovuar.

**E refuzuar:** Nënkupton kërkesat e qytetarëve të cilat nuk përfshihen në buxhetin e komunës për vitin 2026. Kjo mund të jetë për shumë arsye e që mund të përfshijnë: mungesën e mjeteve financiare, fakti që kërkesa nuk bënë pjesë në prioritetet komunale, fakti që kërkesa është më shumë e natyrës individuale se sa me ndikim në komunitet, fakti që për realizimin e kërkesës/investimit do të duhet fillimisht të mënjanohen probleme të ndryshme si shpronësimet apo fakti që menaxhimi i pronës nuk është në kompetencë komunale, etj.

#### **4. TABELARI I DETAJUAR SIPAS KATEGORIVE TË KËRKESAVE DHE STATUSIT QË MARRIN**

Tabelari në vijim paraqet listimin e kërkesave të pranuar, duke i kategorizuar ato në bazë të natyrës që kanë, nëpër kategoritë si në vijim:

- Kërkesat e qytetarëve të natyrës “projekte kapitale”,
- Kërkesat e qytetarëve të natyrës “subvencione”,
- Kërkesat e qytetarëve të natyrës “mallra&sherbime”,
- Kërkesat për informacion apo pyetje të ndryshme rreth progresit në realizimin e “x” invesimit, apo dhënies së “x” subvencionit, e kështu me radhë.

Legjenda e sqarimit të elementeve që gjenden në tabelarin më poshtë:



- Kategorizimi/Emertimi lartë me Capital Letters se a janë kërkesat në vazhdim të natyrës “INVESTIME KAPITALE”, “SUBVENCIONE”, “MALLRA & SHËRBIME”, apo “PYETJE/KËRKESË PËR INFORMACION/SUGJERIME”
- Kolona “Kërkesat, sugjerimet, idetë, pyetjet e parashtruara në konsultim” tregon në mënyrë sa më të detajuar se çfarë përfshinë kërkesa
- Kolona “Emër mbiemër të personit apo organizatës që ka dhënë propozimin/kërkesën”
- Kolona “Statusin e kërkesës se a është Pranuar/Aprovuar, Adresuar, Pjesërisht aprovuar, Refuzuar” – sipas kriterëve dhe metodologjisë së përcaktuar më lartë në kapitullin e mëhershëm
- Kolona “Drejtoria” – tregon për drejtorinë apo njësinë përgjegjëse për adresimin dhe zbatimin e kërkesës së parashtruar.
- Kolona “Përgjigjet dhe arsyeshmërinë e komunës/grupit punues rreth kërkesës/propozimit të qytetarit apo organizatës që ka parashtruar atë, që tregon se cila janë arsytet e klasifikimit të kërkesës/propozimit në Statusin që është përcaktuar. Këtu duhet të jepen arsye dhe përgjigje sa më të detajuara dhe konkrete në mënyrë që qytetari apo organizata ta ketë të qartë se pse një kërkesë e tyre ka marrë statusin e tillë.

**Shtojca 1 – Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e dhëna, arsyetimet për kërkesat e pranuar dhe të refuzuara.**

| INVESTIME KAPITALE |                                                                                                                                    |                                                                    |                                                                                       |                                                           |                                                                                                 |  |
|--------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|--|
| NR.                | Kërkesat / Sugjerimet / Komentet                                                                                                   | Kush ka dhënë kërkesë / sugjerim për projekt buxhetin e vitit 2023 | Statusi i kërkesës/ sugjerimi (i pranuar, pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar) | Drejtoria                                                 | Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimin të komenteve është i detyrueshëm) |  |
| 1).                | Të rregullohet rrethoja e objektit shkollor në këtë fshat Strazhë.                                                                 | Nexhmedin Lika                                                     | E pranuar                                                                             | Drejtoria e Arsimit                                       |                                                                                                 |  |
| 2).                | Rregullimi i një korite të re të kanalizimit, ky projekt është largu dhe është zëvendësuar me një projekt tjetër po në këtë fshat. | Azem Koraqi-                                                       | E pranuar                                                                             | Drejtoria e shërbimeve publike                            |                                                                                                 |  |
| 3).                | Kërkoj që të rregullohet rruga “ Emin Duraku” në Llanishtë<br>Rruga “ Azem Vokshi” të rregullohet kanalizimi.                      | Kadri Dardhishta                                                   | Gjysmë e pranuar                                                                      | Drejtoria e shërbimeve publike dhe Drejtoria e Urbanizmit |                                                                                                 |  |
| 4).                | - Të rregullohet rruga Bajnicë- Semajë.                                                                                            | Hasip Saliu                                                        | E pranuar                                                                             | Drejtoria e shërbimeve                                    |                                                                                                 |  |

|      |                                                                                                                                                                                      |                |                      |                                          |                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
|------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------|----------------------|------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|      |                                                                                                                                                                                      |                |                      | publike dhe<br>Drejtoria e<br>Urbanizmit |                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| 5).  | Lagjja Leka të lidhet Mulliri deri tek rruga Dallosh, vetëm të bëhet zgjerimi i rrugës me zhavorr.                                                                                   | Naser Murseli- | E pranuar            | Drejtoria e Urbanizmit                   |                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| 6).  | Drejtor i Gjinnazit Skenderbeu në Kaçanik-Objekti i Gjinnazit “Skenderbeu” në Kaçanik ka nevojë për rinovim të sallës së edukatës fizike dhe të toaleteve.                           | Shefki Guri    | E pranuar            | Drejtoria e Arsimit                      | Këtë vit do të rregullohen përmes buxhetit komunal                                                                                                                                                                                                                              |
| 7).  | Rregullimi i ngrohjes qendrore një pjesë nuk funksionon, të bëhet rregullimi i saj kur të jenë mundësitë.                                                                            | Nazmi Gashi-   | E pranuar            | Drejtoria e Arsimit                      |                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| 8).  | Ndërtimi i urës për automjete dhe këmbësor mbi lumin Nerodime afër Xhamisë së Dëshmorëve.                                                                                            | Faton Zharku   | E pranuar            | Drejtoria e Urbanizmit                   | Me ndërtimin e urës mbi Lumin Nerodime për momentin janë plotësuar nevojat e qytetarëve.Me siguri se në të ardhmen do të shihet mundësia e ndërtimit edhe të një ure tjetër.Mbetet të analizohet se a ka nevojë një urë edhe për automjete ,apo ura të jetë vetëm për këmbësor. |
| 9).  | Ndërtimi i parkut pas shkollës fillore në lagjen Dushkaja.                                                                                                                           | Faton Zharku   | E pa pranuar         | Drejtoria e Urbanizmit                   | E përshëndesim idenë për ndërtimin e parkut në Dushkajë,në afërsi të shkollës . Megjithate nuk mund të punojmë në këtë drejtim për shkak se prona është në menaxhim të AKP-së.                                                                                                  |
| 10). | Shpallja me interes publik me qëllim të hapjes së trasesë së rrugës përgjatë lumit Nerodime nga “Xhamia e Dëshmorëve” deri te lagjja e Berishëve në Runjevë për zgjerimin e qytetit. | Faton Zharku   | E pranuar pjesërisht | Drejtoria e Urbanizmit                   | Ide shumë e mirë,por shumë e kushtueshme.                                                                                                                                                                                                                                       |
| 11). | Vendosja e barrierave                                                                                                                                                                | Faton          | E pranuar            | Drejtoria e                              | Pa punimin e impiantit                                                                                                                                                                                                                                                          |



|      |                                                                                                                                               |                 |                |                                               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
|------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------|----------------|-----------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|      | lëvizëse në lumin<br>Nerodime përgjatë qytetit<br>me qëllim të akumulimit të<br>ujit.                                                         | Zharku          | pjesërisht     | Urbanizmit                                    | për pastrimin e ujit të<br>lumit<br>Nerodime,projekti nuk<br>do të hyjë në listën e<br>projekteve prioritare të<br>komunës.<br>Ky projekt do të ishte i<br>qëlluar pas punimit të<br>impianitit.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
| 12). | Blerja e paisjeve më<br>moderne për aktivitete<br>kulturore e sportive (si:<br>kamera profesionale,zërim<br>modern,dronë,tv<br>digjital,etj.) | Faton<br>Zharku | E pranuar      | Drejtoria<br>për<br>kulturë,rini<br>dhe sport | Ju falënderojmë për<br>propozimin tuaj të<br>vlefshëm lidhur me<br>blerjen e pajisjeve per<br>aktivitetet kulturore<br>dhe sportive me mjete<br>moderne. Sugjerimi<br>juaj do të merret në<br>konsideratë gjatë<br>hartimit të projekteve<br>dhe planifikimit<br>buxhetor të ardhshëm.<br>Ne jemi të vetëdijshëm<br>për rëndësinë e<br>teknologjive<br>bashkëkohore si<br>kamerat profesionale,<br>sistemet moderne të<br>zërit, dronët dhe<br>pajisjet digjitale, të cilat<br>kontribuojnë<br>drejtpërdrejt në rritjen<br>e cilësisë së<br>aktiviteteve.Institucioni<br>ynë do të shqyrtojë<br>mundësitë financiare<br>dhe bashkëpunimet<br>për të bërë të mundur<br>realizimin e këtij<br>propozimi. |
| 13). | Hartimi i projektit të<br>ndërtimit të liftit te Guri i<br>shpumë;                                                                            | Faton<br>Zharku | E<br>papranuar | Drejtoria<br>për zhvillim<br>ekonomik         | Për shkak të buxhetit të<br>kufizuar që ka komuna<br>në sektorin e Turizmit<br>ky projekt nuk mund të<br>realizohet.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| 14). | Hartimi i projektit të<br>ndërtimit të teleferikut nga<br>Guri i shpumë deri te<br>Kalaja e qytetit;                                          | Faton<br>Zharku | E<br>papranuar | Drejtoria<br>për zhvillim<br>ekonomik         | Për këtë periudhë nuk<br>është paraparë<br>realizimi i këtij<br>ideprojekti.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |



**MALLRA DHE SHËRBIME**

|     |                                                                                                                                                                                                                         |              |           |                                                           |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
|-----|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------|-----------|-----------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1). | Poashtu janë disa përroska që duhet të pastrohen.                                                                                                                                                                       | Azem Koraqi- | E pranuar | Drejtoria e shërbimeve publike                            |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| 2). | Të pastrohen përroskat sepse po rrezikojnë ujësjellësin.                                                                                                                                                                | Hasip Saliu  | E pranuar | Drejtoria e shërbimeve publike dhe Drejtoria e Urbanizmit |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| 3). | Drejtor i Gjimnazit Skenderbeu në Kaçanik- Në shkollën tonë mungojnë edhe katër tabela digjitale për ta kompletuar këtë projekt të digjitalizimit. Po presim që këto tabela ti marrim donacion nga organizata të huaja. | Shefki Guri  | E pranuar | Drejtoria e Arsimit                                       | Këtë vit do të rregullohen përmes buxhetit komunal                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| 4). | Nga vlerësimet e brendshme të shkollave, është vlerësuar që profesorët kanë nevojë për trajnime.                                                                                                                        | Agim Mjaku-  | E pranuar | Drejtoria e Arsimit                                       |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| 5). | Kërkoj që të organizohen trajnime për stafin mësimdhënës në fusha të ndryshme.                                                                                                                                          | Valbona Raka | E pranuar | Drejtoria e Arsimit                                       |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| 6). | Shpallja e Javës së mërgimtarëve kaçanikas (të hartohet një kalendar shtatëditor me aktivitete kulturore dhe sportive);                                                                                                 | Faton Zharku |           | Drejtoria për kulturë,rini dhe sport                      | Kemi pasur kënaqësinë dhe përgjegjësinë ta organizojmë këtë aktivitet edhe gjatë viteve të kaluara, duke u krijuar hapësirë dhe mirëseardhje mërgimtarëve tanë që janë shtylla e rëndësishme e zhvillimit tonë lokal. Për çdo vit, kemi përfshirë aktivitete të ndryshme kulturore dhe sportive, por gjithmonë ka vend për përmirësim. Prandaj, synojmë që edhe vitin e ardhshëm ta pasurojmë |

|      |                                                                                                                                                                                                                               |              |                      |                                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
|------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------|----------------------|-------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|      |                                                                                                                                                                                                                               |              |                      |                                                 | këtë javë me një kalendar shtatëditor të mirëstrukturuar. Qëllimi ynë është që kjo javë të mos jetë vetëm festë, por edhe një urë e fuqishme lidhëse mes vendlindjes dhe diasporës. E kemi nisur këtë traditë dhe jemi të përkushtuar ta vazhdojmë me më shumë përmbajtje dhe përfshirje.                                      |
| 7).  | Shtimi i shërbimit të endokrinologjisë në QKMF;                                                                                                                                                                               | Faton Zharku | Pjesërisht e pranuar | Drejtoria e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale | Sa i përket shërbimit të endokrinologjisë, Specialist i endokrinologjisë nuk është paraparë me Statut të QKMF-së dhe nuk lejohet sipas paragrafit 5 të nenit15 i UA 04/2020. Ndërsa disa shërbime endokrinologjike kryhen në mjekësinë familjare.Së shpejti në laboratorin e QKMF-së fillojmë edhe me analizat t3, t4 dhe tsh. |
| 8).  | Organizimi i një konference vjetore me mërgimtar,biznismen nga Kosova e rajoni si dhe prezantimi nëpërmjet një video të parcelave komunale që jepen për shfrytëzim shumëvjeçar me qëllim krijimin e vendeve të reja të punës; | Faton Zharku | E pranuar            | Drejtoria e Urbanizmit                          | Projekti do të shqyrtohet seriozisht.                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
| 9).  | Klubi Lepenci-Kemi nevojë për disa klima                                                                                                                                                                                      | Januz Bela   | E pranuar            | DKRS                                            | Kërkesa do të realizohet.                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| 10). | Trajnime të fermerëve në fusha të ndryshme nga ekspert të lëmisë së caktuar.                                                                                                                                                  | Shemzi Luzha | E pranuar            | Drejtoria e Bujqësisë                           | Janë tu mbajt trajnime për fermer në fusha të ndryshme.                                                                                                                                                                                                                                                                        |



| SUBVENCIONE                                                                                                                   |                                                                                                                                                                       |                 |                      |                                      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------|----------------------|--------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1).                                                                                                                           | Blerja e paisjeve moderne për mirëmbajtjen e parkut,sheshit,korzave,etj(si makina kositëse,etj.)                                                                      | Faton Zharku    | Pjesërisht           | Drejtoria e shërbimeve publike       | Mirëmbajtja e hapësirave publike në qytet aktualisht bëhet në kuadër të marrëveshjes me KRM"Pastërtia" njësia Kaçanik, të cilët i kanë makineritë e tyre përkatëse për punë, ne do të mundohemi në të ardhmen që në kuadër të subvencioneve do të të bëjmë përmirësime dhe ndihmesa në drejtimin të cilin ju keni kërkuar. |
| 2).                                                                                                                           | Bonevet-Kemi një kërkesë që të na siguroni një lokal,një që na keni propozuar është hapësirë e vogël sepse na nevojitet hapësira e madhe prej 300 m2.                 | Roland Raka     | E pranuar            | Zyrës së Kryetarit                   | Ne si komunë u kemi ofruar një objekt por ka qenë i vogël,do të mundohemi që të identifikojmë ndonjë hapësirë që të jetë e përshtatshme për juve dhe për ushtrimin e aktivitetit tuaj.                                                                                                                                     |
| 3).                                                                                                                           | Tingujt e Vendlindjes-Kërkojmë rritje të subvencioneve,si dhe sigurimin e një hapësire te Shtëpia e Kulturës për mbajtjen e ushtrimeve të shoqërisë sonë.             | Xhevdet Hysa    | E pranuar            | Drejtoria për Kulturë,Rini dhe Sport | Ka rritje të buxhetit te sektori i subvencioneve për vitin e ardhshëm.                                                                                                                                                                                                                                                     |
| KËRKESAT PËR INFORMACION APO PYETJE TË NDRYSHME RRETH PROGRESIT NË REALIZIMIN E "X" INVESTIT, APO DHËNIES SË "X" SUBVENCIONIT |                                                                                                                                                                       |                 |                      |                                      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| 1).                                                                                                                           | Kërkesat në arsim janë të mëdha, po bëhet propagandë, kërkojmë të përfundohet projekti në Shkollën Filllore në Doganaj, projekt i nisur nga ministria tash e sa vite. | Bislim Krasniqi | E pa realizuar       | Drejtoria e Arsimit                  | Projekt nga Ministria e Arsimit, dhe komuna nuk ka mundësi ndikimi që ky projekt të realizohet                                                                                                                                                                                                                             |
| 2).                                                                                                                           | Drejtori i ShMP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka". Sfidat mëdha në arsim , organizatat e huaja më lehtë i përkrahin projektet me                                       | Atdhe Neziraj-  | E pranuar pjesërisht | Drejtoria e Arsimit                  | Komuna e Kacanikut konsideron se përkundër që këto projekte mund të                                                                                                                                                                                                                                                        |



|  |                                                                                              |  |  |  |                                                                                                               |
|--|----------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|--|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|  | sistemet solare, kërkoj që mjetet e ndara për këtë kategori të orientohen në tjera kategori. |  |  |  | mbështeten edhe nga organizatat e huaja, nevoja për investime është e madhe dhe ka vend për të dy investimet. |
|--|----------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|--|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------|

## 5. KONKLUZIONE

Procesi i hartimit të buxhetit komunal për vitin 2026, së bashku me parashikimet për vitet 2027 dhe 2028, ka ecur përpara në përputhje me afatet dhe procedurat e përcaktuara ligjërisht. Gjatë muajve qershor-korrik, është zhvilluar faza e konsultimeve publike, ku kanë marrë pjesë qytetarë, organizata të shoqërisë civile, përfaqësues të bizneseve, këshilla të fshatrave, biznese, të rinj dhe grupe të tjera me interes në këtë proces. Këto konsultime kanë shërbyer si një hapësirë për dialog konstruktiv, duke mundësuar identifikimin dhe adresimin e prioriteteve të komunitetit, me theks të veçantë në nevojat për përmirësimin e infrastrukturës rrugore, sistemit të kanalizimeve, ndriçimit publik, si dhe në përmirësimin e kushteve në institucionet arsimore dhe sportive si dhe mbështetjen për sektorin e bujqësisë.

Edhe pse kjo fazë është përmbyllur me sukses, procesi i miratimit të buxhetit vazhdon të jetë në zhvillim. Është e nevojshme që konsultimet me qytetarë dhe pale te interesit që inicohen nga Kuvendi Komunal gjatë muajit shtator të vazhdojnë, me qëllim që të harmonizohen pritshmëritë me kapacitetet financiare dhe të finalizohet dokumentacioni përfundimtar buxhetor.

Komuna e Kaçanikut mbetet e përkushtuar ndaj një procesi buxhetor gjithëpërfshirës, transparent dhe të përgjegjshëm, me qëllim përmbylljen e nevojave reale të qytetarëve dhe promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe social në territorin e saj.

## 6. AFATET KOHORE

### PËRGATITJA E RAPORTIT

Afati për përgatitjen e Raportit është më së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë dhe jo më shumë se tridhjetë (30) ditë kalendarike, për projekt propozimin që nga dita e përfundimit të afatit për paraqitjen e propozimeve dhe vërejtjeve me shkrim.

### PUBLIKIMI I RAPORTIT

Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas përfundimit të raportit nga grupi punues mbi shqyrtimin publik, raporti dërgohet tek zyrtari përgjegjës për konsultim publik i cili obligohet të siguroj publikimin ueb faqen zyrtare të komunës dhe në platformë për Konsultime publike të qeverisë.

Përgatiti - Drejtoria e Financave, kryesues i grupit

Fitore Vishi


